REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 88/17
Datë/Datum. 04.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr. 88/17

PANELI SHQYRTUES I , i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paqarizi – Referues, z. Blerim Dina - anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE **"Uni Project"** - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare", Lot 1, 2 dhe 3**, me nr. të Prokurimit: MAP202/16/202/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Administratës Publike**, më: 21.04.2017, mori këtë :

V E N D I M

I. Aprovohet, pjesërisht ankesa e OE "Uni Project" - Prishtinë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare", Lot 1, 2 dhe 3**, me nr. të Prokurimit: MAP202/16/202/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Administratës Publike**.

II. Anulohet, vendimi i autoritetit kontraktues **Ministria e Administratës Publike**, lidhur me procedurën e prokurimit me titull **"Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare", Lot 1, 2 dhe 3**, me nr. të Prokurimit: MAP202/16/202/211, si i pa bazuar dhe lënda kthehet ne Ri-vlerësim.

III. **Urdhërohet**, autoritetit kontraktues **Ministria e Administratës Publike**, që procedurën e prokurimit me titull **"Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare", Lot 1, 2 dhe 3**, me nr. të Prokurimit: MAP202/16/202/211, ta kthej në Ri-vlerësim.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj;

V. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Uni Project" - Prishtinë janë pjesërisht të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "Uni Project" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 28.03.2017, me nr. të protokollit, 88/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE "MSS" - Prishtinë, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues, në raportin e datës: 12.04.2017, ka konstatuar se AK-ja, i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë janë të paqëndrueshme, për faktin se AK-ja, i ka verifikuar kontratat e punëtoreve sipas udhëzimeve te dhëna ne vendimin e ne

panelit shqyrtues. Prandaj, eksperti shqyrtues, duke u bazuar në sqarimet e dhëna në raport të ekspertizës i kanë propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe njëherit i kanë propozuar panelit shqyrtues që vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

OE ankues "Uni Project" - Prishtinë në parashtresën e 13.04.2017, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e datës 12.304.2017.

AK-ja, me 13.04.2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 21.04.2017, ne te cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i autorizuar OE ankues si dhe përfaqësuesi i AK-së. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë, përfaqësuesi i autorizuar i OE ankues z. Vrella deklaroj: OE "Uni Project" nuk pajtohet me përmbajtjen e raportit të ekspertit shqyrtues, për arsye se konstatimet në këtë raport nuk janë në pajtim me ligjin e punës dhe ligjin e prokurimit. Pika kontestuese të ankesës, shkurtimisht do ti prezantoj në vazhdim.

Procedura inter partes për zbatimin e nenit 61 të LPP-se, për çmime të ulëta dhe verifikim të sqarimit të ofruara nga OE "MSS", nuk është zbatuar nga AK-ja, sepse nuk është bërë asnjë verifikim se çmimi i ofruar për lotët përkatëse janë çmime të tregut, dhe se këto çmime mbulojnë pagat e punëtorëve, tatimin, shpenzimet e materialit, profitin dhe shpenzimet tjera që ndërlidhen me kryerjen e shërbimeve.

MAP, edhe gjatë procesit të rivlerësimit të ofertave ka konsideruar si valide kontratat e punës për Inxhinierët e prezantuar të cilët njëkohësisht punojnë edhe në kompani tjera. AK-ja, e merr për bazë sqarimin e OE si valid pa pas asnjë bazë ligjore. Ligji punës nuk lejon punësime te punëtorëve në dy vende të punës që fillojnë në orarë zyrtarë, do thotë prej 08 deri në ora 16, për arsye se fizikisht

është e pamundur një gjë e tillë. Këtë konstatim e bazojmë në interpretimin e Ministrisë së punës me datës 19.04.2017 lidhur me këtë çështje dhe ofroj si provë panelit shqyrtues interpretimin e Ministrisë së Punës.

MAP, në rivlerësim të ofertave përsëri nuk ka respektuar nivelin e pagës minimale, pasi në kontratat e stafit të OE "MSS" vërehen paga Neto që janë nën nivelin e pagës minimale të përcaktuar me vendim të Qeverisë nr. 04/33.

Me këtë rast prapë i ofroj si provë panelit shqyrtues një kalkulim të bërë në portalin e ATK-së, ku në mënyrë automatike bëhet kalkulimi i pagave të punëtorëve nga paga neto në bruto apo nga bruto në neto, ku del se pagat e prezantuara për stafin inxhinierik janë nën kundërshtim me vendimin e pagës minimale në Kosovë.

Poashtu ofroj si provë një dokument të marr nga dosja e ofertë së OE "MSS" përmes qasjes në dokumente, ku është lista pagave me gjithë të punësuarit e saj.

Kolona e pestë me radhë ku përcaktohet punëdhënësi, se a është primar apo sekondar. Vërehet se minimalisht se 5 nga 12 inxhinier kanë punëdhënës sekondar OE "MSS", dhe këto janë të shenjëzuara.

OE "Uni Project" kërkon nga paneli që të mos aprovoj si valide dhe ligjore punësimin e punëtorëve në dy kompani private të cilat operojnë në dy industri të ndryshme për një projekt publik, që fillon në orarin e njëjtë zyrtar të punës 08.00 – 16.00. Ose nëse aprovohet një gjë e tillë, që është në kundërshtim me ligjin e punës, atëherë kompania "Uni Porjekt" do thirret në precedent te rastit për këtë çështje në çdo projekt të ardhshëm publik ku ofertojmë në tender të organizuar nga institucionet e Kosovës.

Uni Project kërkon nga paneli shqyrtues që pas shoshitjes së fakteve të marr vendim për të dërguar lëndën në Rivlerësim për lot. 1, 2 dhe 3.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Rugova deklaroj se: Fillimisht jemi pajtuar me mendimin e ekspertit. Mendojmë dhe qëndrojmë pranë asaj se pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme, duke pas parasysh se AK-ja, i ka respektuar te gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore të LPP-së dhe ka trajtuar barabartë gjithë OE-të pjesëmarrës në këtë proces.

Fillimisht AK-ja, e ka respektuar vendimin e panelit për rivlerësim të këtij procesi. Pas formimit të komisionit rivlerësues AK-MAP në harmoni me nenin 72 të LPP-së me datë 02.03.2017 përmes postës elektronike ka kërkuar nga OE "MSS" i shpallur fitues në tri këto lote të jep sqarime të detajuara lidhur me ofertën financiare për te tri lotët dhe stafin profesional të kësaj kompanie.

AK-MAP, me datë 06.03.2017, përmes arkivit të MAP-it, me nr. 757 ka pranuar dokumentacionin nga OE "MSS", dokumentacion i cili në harmoni me nenin 61 të LPP-së për AK-në ka qenë bindës dhe i mjaftueshëm që AK të procedoj tutje. Komisioni vlerësues në këtë rast rekomandon për kontratë OE "MSS".

Besoj që neni 61.1 thotë se nëse AK-ja, pajtohet me dëshmitë e ofruara nga një OE , ka obligim këtë OE të trajtoj në mënyrë të barabartë me OE tjerë.

Këtë e lidhim me faktin se MAP, ka pas kontrata të mëhershme me OE të rekomanduar për kontratë dhe zyra prokurimit në MAP, deri më tani nuk ka pranuar asnjë ankesë nga asnjë palë, duke përfshirë edhe menaxherin e kontratës, që ky OE nuk ka përfunduar gjitha punimet sipas specifikave të dosjes, dhe përgjegjësitë që dalin nga kontrata.

Njëkohësisht duke pas parasysh parimin bazë të LPP-së i cili ka për qëllim ruajtjen e buxhetit, AK-MAP ka vepruar në harmoni të plotë me gjitha dispozitat e LPP-së.

Çështja tjetër , sa i përket vendimit të qeverisë për pagë minimale, mendoj se OE ka dhënë sqarimin e duhur të cilat i ka eksperti shqyrtues si dëshmi ku gjithë stafi profesional i kalon normat e parapara me vendimin e Qeverisë nr. 04/33.

Dëshmitë e ofruara nga OE "MSS" për stafin profesional të dëshmuar me listë të ATK-së, deklaron se i gjithë stafi i angazhuar në këtë kompani do të jetë i punësuar me orar të plotë, prej orës 08.00-16.00.

Ndërsa duhet të cek po ashtu se AK-MAP kriteret për dhënie të kontratës i ka pas tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, dhe nuk ka pas asnjë kriter tjetër që cakton limitin e pagës, dhe kjo çështje mendoj se i mbetet MAP-it apo formuluesit të ligjit të merret me kompanitë, ndërsa AK i mbetet parimi bazë për respektimin e ligjit të LPP-se, me cilin edhe operon.

Si përfaqësues i AK-se, potencoj se MAP ka respektuar gjitha dispozitat e LPP dhe qëndrojmë pranë vendimit të AK-së.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues të prokurimit z. Basha deklaroj: Pas vendimit të panelit nr. 20/17, AK-MAP, ka kërkuar sqarime nga OE sipas udhëzimeve të dhëna në vendim, dhe sipas kërkesës së AK , operatori ekonomik "MSS" ka dhënë përgjigje AK-MAP lidhur me stafin profesional dhe çmimet e ofruara.

Këto pretendime kane qenë të njëjta edhe herën e parë dhe në bazë të përgjigjeve të dhëna nga OE i rekomanduar për kontratë, AK është bindur se me çmimin e ofruar ky OE mund të përfundoj projektin.

Anëtari i panelit z.Paçarizi pyeti ekspertin se sqarimet e dhëna nga OE a janë në pajtim me ligjin e punës.

Në përgjigje z.Basha dekarloj: Sqaroj fillimisht se edhe herën e parë në raportin e ekspertizës kam deklaruar po ashtu edhe në seancë se nuk është kërkuar pagë në dosje te tenderit, por vetëm staf profesional i kualifikuar. Ky ka qenë pretendim i OE ankues edhe herën e parë dhe herën e dytë. Mirëpo ligji dhe rregullorja nuk më lejon të dal jashtë pretendimeve ankimore për faktin se nuk ka qenë pjesë e dosjes paga minimale.

Anëtari i panelit z.Dina pyeti ekspertin shqyrtues se sipas ofertës së OE "MSS", a i plotëson sipas ligjit të punës dhe vendimeve të qeverisë kriteret stafi i kompanisë së këtij OE.

Në përgjigje z.Basha deklaroj: Kontratat e stafit profesional të OE të rekomanduar janë edhe disa kontrata tjera me disa OE, mirëpo ato janë kontrata siç kam sqaruar më herët të viteve 2010-2011 me OE Rexha, ndërsa kontratat e stafit profesional janë të nënshkruara dhe vulosura në nëntor të vitit 2016 me OE "MSS". AK-ja, nuk ka kërkuar pagë minimale apo në bazë të moshës për staf profesional. Kërkesë ka qenë vetëm të jetë stafi me kualifikimet e duhura.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Vrella deklaroj: Sa i përket pyetjes parë, te FTD kërkohet në mënyrë eksplicite që për stafin inxhinierik të ofrohen kontratat valide, CV dhe diploma përkatëse. Në dokumentacionin që kemi marr prej ofertë së OE "MSS" te datës 02.03.2017 ceket se ky staf ka punëdhënës sekondar OE "MSS".

Me interpretim të MPMS siç cekëm shumë sqarohet çka do thotë sekondarë, dhe me këtë dihet se nuk është staf primar.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Rugova deklaroj: Pretendimi i OE nuk qëndron pasi kontratat e punës të ofruara nga OE ceket saktë dhe qartë se orari punës do jetë 08-16, dhe kontratat janë origjinal të nënshkruara nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, dhe paga cekur në kontratë i plotëson te gjitha kriteret e vendimit të qeverisë dhe ligjit të punës. Mendoj se këtu nuk ka diçka tjetër që duhet shtuar.

E rëndësishme është për AK-në që stafin profesional sipas kërkesave dhe dosjes të ketë në vendpunishte në harmoni të plotë me kriteret e dosjes.

OE fitues ka ofruar gjitha këto dëshmi të cilat kanë qenë bindëse për AK-në dhe mendoj se pretendimet e OE ankues janë të pabaza.

Kalkulimi i ofruar nga OE ankues përmes ATK, lus panelin të marr parasysh sqarimet e dhëna nga OE i rekomanduar për kontratë pasi përmes kësaj shihet se OE i rekomanduar plotëson kushtin për pagë bazë sipas vendimit. OE "MSS" poashtu ka deklaratë nën betim se do ofroj dëshmitë sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë që për ne janë bindëse.

I propozojmë panelit shqyrtues të refuzohet ankesa e OE ankues dhe të vërtetohet vendimi i AK-së.

Kryetari i panelit pyeti përfaqësuesin e OE ankues se a keni dëshmi për punësimin e këtyre personave në dy kompani siç pretendoni ju, gjegjësisht a keni dëshmi se punëtorët e OE "MSS" siç pretendoni janë të punësuar diku tjetër.

Në përgjigje z.Vrella dekarloj: Uni Project është e prirur ti besoj institucioneve të shtetit dhe për këtë arsye të gjitha pretendimet tona ankimore janë bazuar në dokumente zyrtare të lëshuara nga këto institucione, në rastin konkret dokumenti i lëshuar nga ATK-ja, që ka nxjerr vet OE i rekomanduar dhe interpretimin ligjorë të MPMS. Në ATK, bëhet azhurnimi për secilin punëdhënës për çdo muaj bëhet deklarimi, në mënyrë elektronike.

Për çdo punonjës në listë të pagave si punonjës kam obligim të deklaroj nëse jam punonjës primar apo sekondar. Pikërisht në këtë listë inxhinierët në ofertë të OE "MSS", kanë këtë OE si punëdhënës sekondar.

Nga gjeturat tona minimum 5 nga inxhinierët e kanë punëdhënës sekondar OE "MSS", që i bie se punëdhënës primar e kanë dikë tjetër. Dëshmive të AK-se për pagat e prezantuara nga OE me rastin e rivlerësimit nuk duhet të merren për bazë pasi ato janë bërë pas dorëzimit të ofertave.

Në momentin e dorëzimit të ofertës muajin dhjetor janë dorëzuar pagat të cilat veç se ua kemi prezantuar më herët përmes dëshmive dhe kontratave të tyre.

Në fund z.Vrella dekoroj: Kërkojmë të pranohet ankesa jonë si e bazuar dhe lënda të tehet në Rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare eksperti shqyrtues deklaroj se qëndroj pranë raportit të ekspertizës nr.88/16.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues lidhur me pagën

minimale te punëtoreve te OE "MSS", për faktin se pas sqarimeve te kërkuara nga AK-ja, me date: 06.03.2017 ne përgjigje OE i rekomanduar për kontratë ka sqaruar se dhe njëherit ka përllogaritur pagën minimale te punëtoreve e cila nuk ka rezultuar te jetë sipas vendimit te Qeverise se Republikës se Kosovës me numër 04/33. Ne diapozitivin e parë, ne pikën 1.2 te vendimit me numër 04/33 te Qeverise se Republikës se Kosovës te datës 17.08.2011 është paraparë qe paga minimale për punëtorë mbi moshën 35 vjeç të jetë 170 euro, e ne rastin konkrete OE "MSS", në sqarimet e dhëna nga vet OE "MSS", nuk ka mundur te argumentoj pagën minimale te stafit të prezantuar ne oferta sipas vendimit te lartpërmendur.

Paneli shqyrtues poashtu konstaton se sqarimet e dhëna nga OE "MSS" se punëtorët e prezantuar nga janari i vitit 2017 kane paga 230 euro, janë te pa baza dhe nuk mund te merren parasysh për faktin se këto dokumente mbajnë datën pas hapjes se ofertave dhe ky fakt është i sanksionuar ne nenin 72 te LPP-se ku thuhet, citat: "Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive".

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Ministria e Administratës Publike"

1x1 OE "Uni Project" - Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.